

Znj. Ejvis Gishti (Shehi) ka lindur në Tiranë, më 2 mars 1975. Ejvis është diplomuar për Menaxhim në vitin 1997 në Universitetin e Tiranës, ka përfunduar Master në "Business Trainer and Consultant", organizuar në kuadrin e Paktit të Stabilitetit në Tiranë-Gjermani, si dhe master në "Financë – Menaxhim Banke", Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Aktualisht është Kandidate për doktore shkencash.

Ejvis ka më shumë se 20 vjet përvojë pune. Aktualisht, është drejtore e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, dhe prej më shumë se 10 vite është angazhuar në pozicione drejtuese në administratën publike dhe kryesisht në fushën e arsimit dhe formimit profesional si dhe të tregut të punës. Prej më se 5 vitesh, është anëtare e Bordit Këshillimor të Kornizës Europiane të Kualifikimeve në Bruksel. Aktualisht është bashkëkryetare e Task Forcës për Zhvillimin dhe Zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, ku ka qenë anëtare prej më se 6 vitesh.

Gjithashtu, Ejvis është Koordinator e e dy projekteve në kuadrin e programit ERASMUS+, për "Platformën Elektronike Europiane për të Edukimin e të Rriturve në Ahqipëri", dhe "National Coordinators for the Implementation of the European Agenda for Adult Learning", si dhe të projektit "Fostering Opportunities of Refugee WORKers" (FORWORK) në kuadrin e programit EASI.

Ejvis është angazhuar prej 18 vitesh si lektore me kohë të pjesshme në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, në Fakultetin e Ekonomisë, më Universitetin e Tiranës, dhe mbi 4 vite si lektore me kohë të pjesshme në fushën e njohurive ekonomike në Universitetin e Sportit të Tiranës. Është autore e mbi 20 publikimeve në fushën e arsimit, të tregut të punës dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore.